



BULETIN MUJOR

SHTATOR 2024



PËRMBAJTJA


- Firmoset Marrëveshja për Sigurinë Kibernetike midis Shqipërisë dhe Italisë
- Shqipëria ngjitet me 23 vende në Indeksin Global të Sigurisë Kibernetike 2024, sipas ITU
- AKSK Zhvillon Trajtime për Higjienën Kibernetike në Shkodër dhe Korçë
- Organizohet Tryezë Diskutimi për Përfshirjen e Ballkanit Perëndimor në Politikën e Sigurisë Kibernetike të BE-së
- AKSK Nis Aktivitetet Ndërgjegjësuese për Mbrojtjen Online të Fëmijëve në Shkolla
- AKSK Rrit Aftësitë e Sigurisë Kibernetike për Sektorin e Shëndetësisë dhe Institucionet Ligjzbatuese

Firmoset Marrëveshja për Sigurinë Kibernetike midis Shqipërisë dhe Italisë



Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Italisë, shënon një hap të rëndësishëm në forcimin e sigurisë kibernetike midis dy vendeve. Marrëveshja synon të nxisë shkëmbimin e informacionit mbi kërcënimet kibernetike, ndarjen e praktikave më të mira dhe forcimin e kapaciteteve teknologjike, duke mbështetur qëndrueshmërinë e infrastrukturave kritike. Ky bashkëpunim thelbësor konsolidon marrëdhëniet dypalëshe dhe krijon një front të përbashkët përballë sfidave globale në fushën e sigurisë kibernetike.

Shqipëria ngjitet me **23 vende+** në Indeksin Global të Sigurisë Kibernetike (ITU)



Shqipëria ngjitet me 23 vende në Indeksin Global të Sigurisë Kibernetike 2024, sipas ITU

Në raportin e fundit të publikuar nga ITU, Shqipëria ka bërë një përparim të jashtëzakonshëm duke u ngjitur me 23 vende në renditjen globale të sigurisë kibernetike, krahasuar me raportin e mëparshëm. Aktualisht, vendi ynë bazuar në pikët e performancës renditet në vendin e 57-të në nivel global, nga vendi i 80-të që ishte më parë, dhe ka përmirësuar pozicionin e tij në Evropë duke u ngjitur nga vendi i 40-të në vendin e 30-të.

Ky progres e vendos Shqipërinë në grupin "Tier 2," që përfshin vendet që po avancojnë shpejt në sigurinë digjitale, duke dëshmuar përkushtimin e saj për të përballuar sfidat globale në këtë fushë.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aksk.gov.al



@aksk.gov.al



+355 422 21 039



AKSK ZHVILLON TRAJNIME PËR HIGJENËN KIBERNETIKE NË SHKODËR DHE KORÇË

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), në bashkëpunim me CRDF Global dhe Departamentin Amerikan të Shtetit, zhvilloi trajnime mbi higjienën kibernetike në Shkodër dhe Korçë, me pjesëmarrjen e mbi 1,500 personave. Trajnimet synuan përmirësimin e aftësive për mbrojtjen nga sulmet kibernetike dhe minimizimin e rreziqeve nga gabimet njerëzore, që shkaktojnë shumicën e incidenteve kibernetike. Kjo nismë vazhdon të zgjerohet në të gjithë vendin për të rritur ndërgjegjësimin mbi sigurinë digjitale.

ORGANIZOHET TRYEZË DISKUTIMI PËR PËRFSHIRJEN E BALLKANIT PERËNDIMOR NË POLITIKAT E SIGURISË KIBERNETIKE TË BE-SË

AKSK në partneritet me KCSS dhe Open Society Foundation, organizoi një tryezë të rumbullakët për përfshirjen e Ballkanit Perëndimor në politikat e sigurisë kibernetike të Bashkimit Europian. Përfaqësues nga rajoni dhe BE-ja diskutuan nevojën për bashkëpunim të ngushtë për të forcuar infrastrukturën mbrojtëse dhe për të përballuar sfidat kibernetike. Drejtori i AKSK-së, z. Igli Tafa, theksoi rëndësinë e një qasjeje të koordinuar për mbrojtjen e institucioneve dhe qytetarëve, ndërsa u nënvizua roli i shkëmbimit të njohurive dhe përvojave në rritjen e kapaciteteve mbrojtëse.



AKSK RRIT AFTËSITË E SIGURISË KIBERNETIKE PËR SEKTORIN E SHËNDETËSISË DHE INSTITUCIONET LIGJZBATUESE

AKSK organizoi një trajnim dy-ditor për sektorin e shëndetësisë dhe institucionet e pavarura ligjzbatuese, me fokus në rritjen e ndërgjegjësisë dhe aftësive të personelit IT/ICT për sigurinë kibernetike. Pjesëmarrësit përfituan njohuri të thelluara mbi mbrojtjen e perimetrit të rrjetit, menaxhimin e logeve, mbrojtjen e sistemeve fundore dhe përdorimin e platformave Open Source.

AKSK NIS AKTIVITETET NDËRGJEGJËSUESE PËR MBROJTJEN ONLINE TË FËMIJËVE NË SHKOLLA

AKSK në bashkëpunim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, ka rinisur fushatën ndërgjegjëse për mbrojtjen online të fëmijëve dhe të rinjve. Në shkollën "Ahmet Zogu" në Kamëz u mbajt taikimi i parë, pjesë e një nisme më të gjerë komëtare e cila, që nga janari, ka përfshirë rreth 600 nxënës nga 13 shkolla në vend. Këto aktivitete do të vazhdojnë gjatë gjithë vitit shkollor për të ndihmuar brezin e ri të përdorë internetin në mënyrë të sigurt.

